



IMUNITETI I GJYQTARËVE NË SHQIPËRI (Shtator 2011)



Tabela e Përmbajtjes

1.	Shënime paraprake: koncepti i imunitetit	3
1.1.	Imuniteti dhe pacenueshmëria	4
1.2.	Mospërgjegjësia dhe papërgjegjshmëria	4
1.3.	Perspektiva për imunitetin	5
2.	Standarde europiane dhe ndërkombëtare për imunitetin e gjyqtarëve	7
2.1.	Standardet më të zakonshme ndërkombëtare për imunitetin e gjyqtarëve	7
2.2.	Përfundimet për standardet ndërkombëtare	9
3.	Rregullimi i imunitetit të gjyqtarëve në ligjin shqiptar	11
3.1.1.	Imuniteti përpara Kushtetutës së 1998	11
3.1.2.	Rregullimi i imunitetit që në 1998.....	12
4.	Problemet e imunitetit të gjyqtarëve në Shqipëri dhe shkaqet e tyre	16
4.1.	Probleme në lidhje me luftën kundër korrupsionit.....	17
4.2.	Probleme në lidhje me barazinë përpara ligjit	18
4.3.	Probleme procedurale.....	18
5.	Përmirësime të sugjeruara për situatën shqiptare.....	20
5.1.	Reformimi i procedurave për heqjen e imunitetit	21
5.2.	Reformimi i ligjeve për procedurën.....	22
5.3.	Reformimi i Kushtetutës.....	22
5.3.1.	Në lidhje me imunitetin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.....	23
5.3.2.	Në lidhje me imunitetin e gjyqtarëve.....	24
6.	PËRFUNDIME.....	25
6.1.	Rekomandime për reformimin e imunitetit të gjyqtarëve.....	25
6.2.	Propozim konkret në lidhje me ndryshimin e Kushtetutës:.....	25

1. SHËNIME PARAPRAKE: KONCEPTI I IMUNITETIT

Ideja themelore e çdo shteti që bazohet në shtetin e së drejtës është barazia përpara ligjit. Kjo barazi, në radhë të parë do të thotë, përgjegjshmëria e të gjitha pushteteve ndaj ligjit.

Thelbi i demokracisë është shteti i së drejtës. Askush brenda një shteti demokratik nuk mund të refuzojë t'ju bindet ligjeve dhe ligjet janë të barabartë për të gjithë. Demokraci ka vetëm kur ligji zbatohet njësoj për njerëzit në pushtet, autoritetet dhe qytetarët.

Për këtë arsye, çdo përjashtim nga parimi i plotësisë në zbatimin e ligjit shkel vlerat bazë të shoqërisë tonë. Prandaj këto përjashtime janë të pranueshme vetëm kur kanë të bëjnë me një çështje të fortë, gjithmonë të interpretuar në mënyrë të kufizuar.

Imuniteti është privilegji i autoriteteve të larta për të mos dhënë llogari sipas ligjit. Është përjashtimi kryesor ndaj parimit të barazisë përpara ligjit në një shtet kushtetues dhe përligjet vetëm për të garantuar pavarësinë e këtyre autoriteteve, si garanci e vetë demokracisë.

Ky përjashtim është prezantuar në sistemet tona ligjore si një mbrojtje për pavarësinë e disa institucioneve duke shmangur përdorimin e procedimeve të padrejta gjyqësore dhe masave të përkohshme për kufizimin e të lirisë së tyre të zgjedhjes. Në këtë mënyrë, imuniteti nevojitet si garanci kundër keqpërdorimit të pushtetit të pavarur të gjyqësorit që synon reduktimin e lirisë kushtetuese të institucioneve të tjera shtetërore ose të një gjyqtari.

Dukshëm, nevoja për këto garanci është në lidhje të drejtpërdrejtë me nivelin e pavarësisë dhe asnjansisë të pushtetit gjyqësor në çdo shtet. Sa më i lartë të jetë profesionalizmi, aq më e vogël është shtrirja e nevojës për imunitet nga autoritetet e pavarura.

Kështu, në disa vende të zhvilluara europiane, vitin e fundit është rritur kërkesa sociale për të ulur imunitetin, aq sa nuk është më i nevojshëm dhe vetë institucioni mund të përdoret kundër kuptimit të tij fillestar.

Ashtu siç e theksojnë disa raporte ndërkombëtare, në shumë vende, zyrtarë të lartë shtetërorë mbrohen nga imuniteti aq shumë sa shpesh kriminelët kërkojnë pozicione shtetërore thjesht për të shmangur ndjekjen. Në këto raste, ekziston rrezik i lartë për rrethin vicioz të korrupsionit; parlamenti, për shkak të mbrojtjes së tij të privilegjuar, tërheq individë të pamoralshëm që më pas vazhdojnë dhe shtojnë sjellje korruptive. Disa individë në nevojë për mbrojtje juridike kanë arritur me ryshfet të përfshihen në listat zgjedhore të partive për të siguruar imunitet.¹ Nga ana tjetër, nëse imuniteti i gjyqtarëve shihet si një lloj përjashtimi nga ndëshkimi mund të bëhet mburojë për të mbrojtur praktika korruptive.

Në përfundim, në shtetet moderne lind nevoja për të gjetur një ekuilibër të duhur ndërmjet nevojës për mbrojtje të pavarësisë së aktorëve kushtetues dhe nevojës për kontroll ligjor të të gjitha pushteteve të ushtruara brenda shtetit. Mungesa e zhvillimeve

¹ Praktikant më të mira në luftën kundër korrupsionit, Vjenë, OSBE, 2004, Kapitulli 5.

ligjore dhe boshllëqet në shtetin e së drejtës mund të merren parasysh për rritjen e kontrollit mbi keqpërdorimin e kompetencave zyrtare, por dhe për rritjen e mbrojtjes kundër sulmeve të papërshtatshme ndaj pavarësisë së tyre.

1.1 Imuniteti dhe pacenueshmëria

Kur flasim për imunitetin, problemi i parë janë fjalët. Tradita të ndryshme ligjore përdorin shprehjet “imunitet” dhe “pacenueshmëri” për t’ju referuar realiteteve të ndryshme: Në sistemin kontinental të së drejtës, imuniteti ndryshon nga pacenueshmëria. *Pacenueshmëria* nënkupton një përjashtim absolut nga përgjegjësia penale ndërsa *imuniteti* përfshin krijimin e barrierave ligjore ndaj ndjekjes për një krim.

Megjithatë, në traditën e *common law*, fjala “imunitet” përdoret në mënyrë më të përgjithshme, duke iu referuar çdo kufizimi nga një detyrim ligjor, ndëshkim ose ndjekje. Prandaj, bëhet një dallim ndërmjet *imunitetit absolut*, që bën të pamundur përgjegjshmërinë dhe *imunitetit relativ*, që përbën një barrierë të përkohshme dhe kushtëzuese ndaj procedimeve penale.

Si rezultat, ndodh që në Europë, shpesh përdoret fjala “imunitet” për t’iu referuar fjalës “pacenueshmëri” që përdoret në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Në çdo rast, ky është vetëm një problem terminologjie, pasi në të dy sistemet është e qartë që ka dy lloje të ndryshme përjashtimesh nga përgjegjësia ligjore për disa autoritete.

1.2 Mospërgjegjësia dhe papërgjegjshmëria

Pacenueshmëria (që ne do e quajmë **mospërgjegjësi**) ndalon ndjekjen e disa personave për krime që janë kryer në ushtrimin e detyrës ose funksionit të tyre. Kjo nënkupton që e drejta penale nuk zbatohet për ata. Përdoret kryesisht në lidhje me deklaratat e lëshuara në ushtrimin funksioneve gjyqësore ose parlamentare dhe është privilegj i vazhdueshëm. Është tërësisht ekuivalent me privilegjin kushtetues në SHBA të anëtarëve të kongresit për të bërë deklaratat verbale “në takim dhe në komitet”, deklaratat për të cilat ata nuk mund të paditen ose arrestohen për shpifje. Është një privilegj absolut i vazhdueshëm, pasi autoritetet nuk mund të ndiqen për këto fakte edhe pasi mbarojnë funksionet e tyre.

Privilegji i dytë është **papërgjegjshmëria** (që në Europë quhet imunitet dhe në SHBA quhet pacenueshmëri) e cila mbron autoritetet nga ndjekja civile, administrative ose penale për deklaratat ose akte që nuk kanë lidhje me ushtrimin e mandateve të tyre zyrtare. Ky lloj imuniteti është një garanci e përkohshme procedurale. Arrestimi ose ndjekja e personave nuk duhet kryer gjatë kohës të tyre në detyrë, përveçse me leje paraprake nga institucioni të cilit i përkasin. Kjo është pengesë për ushtrimin e juridiksionit, por nuk është shkak për përjashtim nga ndëshkimi.

Përfituesit e një forme mospërgjegjësie janë diplomatët, deputetët dhe gjyqtarët.

Imuniteti i diplomatëve është parashikuar në Konventën e Vjenës të 1961 për marrëdhëniet diplomatike. Kështu, diplomatët e shteteve të huaja përfitojnë imunitet ndaj ndjekjes penale për shumë vepra penale, si dhe imunitet ndaj shumë padive civile.

Origjina e imunitetit parlamentar daton nga koha kur gjyqësori kontrollohej nga pushteti ekzekutiv dhe mund të përdoret kundër pavarësisë së deputetëve. Në vende ku pushteti gjyqësor është dukshëm i pavarur, fillon të kuptohet si një privilegj i pakuptimtë që duhet pakësuar.

Pavarësia gjyqësore është një formë e imunitetit juridik që mbron gjyqtarët dhe të tjerë të punësuar në gjyqësor nga ankesat e depozituara kundër tyre për sjelljen e tyre në detyrë, dhe i mbron ata kundër kriminelëve, mbron familjen dhe pronën e tyre gjatë kohës së tyre në detyrë.

Ka edhe **privilegje të tjera procedurale** si përcaktimi i një juridiksioni të veçantë ose procedurë para gjyqit. Juridiksion i veçantë do të thotë që një person të gjykohet nga një gjykatë më e lartë sesa gjykata që gjykon njerëzit në përgjithësi. Procedurë para gjyqit do të thotë që disa subjekte mund të ndiqen nga gjyqësori vetëm nëse një organ i institucionit të tyre (zakonisht një Komitet i Kongresit ose i Këshillit Drejtues të Gjyqësorit). Kjo ndodh vetëm në çështje penale.

1.3 Perspektiva për imunitetin

Është e qartë që diskutimi praktik për imunitetin lidhet gjithmonë me shkallën e imunitetave në çdo vend dhe me momentin historik. Nuk ka asnjë vend në botë që nuk u jep autoriteteve të larta ndonjë lloj imuniteti. Prandaj, shumë pyetje kërkojnë përgjigje për të qartësuar modelin e imunitetit në një sistem ligjor:

- Kush përfiton nga një formë e imunitetit? Zakonisht përfshihet Kreu i Shtetit, deputetët, gjyqtarët e gjykatës kushtetuese, gjyqtarët e gjykatës së lartë, gjyqtarë të tjerë, prokurorë, autoritete të tjera.

- Nga këto kategori, cilët përfitojnë nga papërgjegjshmëria për opinionet e shprehura në ushtrim të detyrës? Këtu përfshihet gjithashtu mospërgjegjësia e gjyqtarëve për vendimet e marra gjatë ushtrimit të funksionit (i ashtuquajtur imunitet funksional).

- Kush përfiton nga një lloj papërgjegjshmërie ndaj çështjeve penale, civile dhe administrative, që nuk lidhen direkt me ushtrimin e funksioneve të tyre?

- Cilat janë procedurat për heqjen e imunitetit, pra cilat janë organet që mund të autorizojnë ndjekjen gjyqësore të autoriteteve të mbrojtura, dhe cilat janë procedurat që ndiqen?

Në përfundim, problemi i imunitetit është një problem intensiv më shumë sesa një çështje e thjeshtë për të pranuar apo jo imunitetin në të gjitha institucionet.

Megjithatë, për sa i përket këtij raporti, termat e mëposhtme do të kuptohen si vijon:

- **Pacenueshmëri personale.** Është ndalimi për të mos u arrestuar, apo nënshtruar një kufizimi ndaj lirisë së lëvizjes pa autorizim paraprak të një organi më të lartë.

- **Imunitet funksional.** Është ndalimi për të filluar një procedurë civile ose penale bazuar në akte të kryera në ushtrimin aktual të funksioneve. Kjo përfshin papërgjegjshmërinë për shprehje/deklarata zyrtare.

- **Imunitet i përgjithshëm.** Është ndalimi absolut për të filluar procedim gjyqësor kundër një autoriteti pa autorizimin paraprak të një organi.

2. STANDARDE EUROPIANE DHE NDËRKOMBËTARE PËR IMUNITETIN E GJYQARËVE

Pavarësia e gjyqtarëve është një kusht i detyrueshëm për shtetin e së drejtës dhe garancia themelore për një proces me të drejta të barabarta. Shteti e garanton këtë pavarësi (p.1 Parimet bazë të OKB-së në lidhje me pavarësinë e drejtësisë, të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së më 29 nëntor 1985). Kështu në procesin e vendimmarrjes, gjyqtarët duhet të jenë të pavarur dhe të jenë në gjendje të veprojnë pa kufizim, ndikim të papërshtatshëm, nxitje, presion, kërcënim ose ndërhyrje, direkt ose jo, nga çdo organ ose për çfarëdo arsye. Ligji duhet të parashikojë sanksione kundër personave që kërkojnë të ndikojnë tek gjyqtarët në ndonjë nga këto mënyra. Gjyqtarët duhet të kenë liri të pakufizuar për të vendosur në mënyrë të paanshme për çështje, në përputhje me ndërgjegjen dhe interpretimin që i bëjnë ata fakteve, dhe në përputhje me rregullat mbizotëruese. Gjyqtarët nuk duhet të detyrohen t'i raportojnë dikujt jashtë gjyqësorit për themelin e çështjeve.²

Niveli i garancive që do të siguronte pavarësinë mund të variojë nga një kartë tek tjetra, në varësi të nivelit të demokracisë në çdo shtet. Sa më shumë konsiderohet i ulët niveli i demokracisë së një shteti, aq më të larta duhet të jenë garancitë për pavarësinë e gjyqtarëve.

2.1 Standardet më të zakonshme ndërkombëtare për imunitetin e gjyqtarëve

Përcaktimi i disa procedurave të veçanta për hetimin e gjyqtarëve mund të jetë garanci për sigurimin e pavarësisë. Kufizimet për përgjegjësinë civile dhe penale të gjyqtarëve mund t'i mbrojnë ata kundër ndërhyrjeve të parregullta. Një opinion i mbarë përhapur është që hetimi i gjyqtarëve duhet t'i nënshtrohet formaliteteve më komplekse sesa ato të përgjithshme për qytetarët e tjerë. Sipas Projektit të Deklaratës Universale për Pavarësinë e Drejtësisë (*Shingvi Declaration*), të miratuar me Rezolutën nr 1989/32 të Komisionit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut "Gjyqtarët do të mbrohen nga procesi gjyqësor kundër tyre në lidhje me funksionet e tyre gjyqësore dhe nuk do të ndiqen apo paditen përveçse me autorizimin e një autoriteti gjyqësor të përshtatshëm" (fq 20). Kështu, gjyqtarët nuk duhet t'i nënshtrohen **hetimit**, nëse nuk ka një autorizim nga një autoritet gjyqësor kompetent (fq 20).

Opinionin nr 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë (CCJE) në vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës (2002) përmban një shtojcë me procedurat për procedim penal kundër gjyqtarëve në vendet anëtare të Këshillit të Europës. Rezultati i këtij kërkimi ishte që në 2001, nuk ka një standard të përgjithshëm për imunitetin.

² Komisioni i Venecias, Rekomandim (94)12, parimi I.2.d.

Në disa nga vendet me sistem të konsoliduar demokratik dhe kushtetues, rregulli është që gjyqtarët i nënshtrohen një procedimi penal të zakonshëm. I tillë është rasti në Francë, Gjermani, Finlandë apo Holandë.

Ndërmjet vendeve me procedura të veçanta për procedim penal kundër gjyqtarëve, këto procedura janë shumë të ndryshme. Në disa vende, si në Norvegji dhe Portugali është vetëm garanci e një juridiksioni të veçantë, ku akuzat kundër gjyqtarëve paraqiten nga një gjykatë më e lartë sesa gjykata e tyre. Në Belgjikë, padia penale kundër gjyqtarëve është vetëm në dorë të prokurorit pranë gjykatës së apelit.

Në periudha të tranzicionit social dhe sidomos pas periudhave të gjata të diktaturës, ideja e përgjithshme është që gjyqtarët kanë nevojë për mbrojtje të veçantë kundër keqpërdorimit të padive penale kundër tyre. Pothuajse të gjitha ish vendet komuniste i kanë këto garanci: në Republikën Çeke, procedimet penale kundër gjyqtarëve mund të autorizohen nga Presidenti i Republikës. Në Lituani dhe Slloveni, ndjekja penale kundër një gjyqtari mund të autorizohet nga parlamenti (po kështu dhe në Zvicër). Në Rumani nevojitet mendimi paraprak i Ministrisë ose Presidentit. Në Sllovakia, procedimi penal duhet të autorizohet nga organi që ka emëruar gjyqtarin. Në Poloni, procedimi penal duhet të autorizohet nga Gjykata e Çështjeve të Disiplinës. Në Ukrainë nga Këshilli i Lartë. Nga ana tjetër, në shtetet e së drejtës zakonore, rregulli i zakonshëm është imuniteti i gjyqtarëve.

Sipas Praktikave më të Mira të OSBE-së për Luftën Kundër Korrupsionit (2004), imuniteti i gjyqtarëve paraqet një vështirësi të veçantë. Përgjithësisht ata kanë imunitet për të mos u paditur personalisht për gabime që mund të kenë bërë në vendime (për shembull, tejkalim të juridiksionit) dhe për t'u mbrojtur nga presionet politike, ata përgjithësisht kanë imunitet, përveç rasteve kur u hiqet imuniteti. Në rastin e Estonisë, dokumenti i GRECO-s, rekomandon që çdo vendim për të hequr pacenueshmërinë e gjyqtarëve nuk duhet të merret nën ndikime politike. Duhet të jetë vendim i bazuar në kërkesën e prokurorit, mbështetur nga Gjykata e Lartë.³

Prandaj, mund të arrijmë në përfundimin që shkalla e imunitetit që përfitojnë gjyqtarët lidhet më shumë me situatën sociale si një demokraci e konsoliduar dhe sistemin ligjor në çdo vend. Nuk ekziston një standard i përbashkët që të zbatohet aktualisht në të gjitha shtetet europiane. Kështu çështja kryesore mund të trajtohet vetëm me një analizë të thellë të shkallës së imunitetit të gjyqtarëve, që nevojitet në çdo vend dhe në çdo moment historik për të mbajtur një ekuilibër proporcional ndërmjet **përgjegjësisë** dhe **pavarësisë** së gjyqtarëve.

Standardet e përgjithshme të vendeve europiane më të zhvilluara garantojnë vetëm imunitet funksional ndaj padive civile dhe kërkesave penale bazuar në ushtrimin e funksioneve të tyre. Në lidhje me përgjegjësinë penale, gjyqtarët duhet të përgjigjen penalisht për vepra penale të kryera jashtë mandatit të tyre gjyqësor; gjyqtarët nuk mbajnë

³ Praktikave më të mira në luftën kundër korrupsionit, Vjenë, OSBE, 2004, Kapitulli 5.

përgjegjësi penale për dështime të paqëllimshme në ushtrimin e funksioneve të tyre.⁴ Në lidhje me përgjegjësinë civile, duke pasur parasysh parimin e pavarësisë, zgjidhja për gabimet gjyqësore (në lidhje me juridiksionin, procedurën apo lëndën) duhet të qëndrojë në një sistem të duhur të apelimeve (me apo pa lejen e gjykatës).

Zgjidhja për dështime të tjera në administrimin e drejtësisë (duke përfshirë vonesat e tepërta) qëndron vetëm tek shteti. Prandaj, nuk është e duhur që një gjyqtar, në lidhje me ushtrimin e synuar të funksionit gjyqësor, të vihet përpara përgjegjësisë personale, edhe me anë të kompensimit nga shteti, përveç rastit të një mosveprimi/dështimi të qëllimshëm. Sipas opinionit të sipër përmendur të CCJE, në rast të sjelljeve të gabuara flagrante të gjyqtarëve “nevoja për kujdes në njohjen e kësaj përgjegjësie lind nga nevoja për të ruajtur pavarësinë gjyqësore dhe lirinë nga presione të parregullta. Kundrejt këtij sfondi, CCJE konsideron nga ana e saj çështjen e përgjegjësisë penale, civile dhe disiplinore. Në praktikë, më e rëndësishme është përgjegjësia e mundshme disiplinore e gjyqtarëve”.⁵

Këto përfundime duhen cilësuar në lidhje me gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të cilët nuk janë anëtarë të gjyqësorit dhe përfitojnë privilegje dhe imunitet më të gjerë. Duke ju referuar atyre, një studim i Komisionit të Venecias në 1997 tregoi këtë rezultat: shumica e gjykatave që janë studiuar rezervojnë të paktën imunitet të pjesshëm ndaj ndjekjes së anëtarëve të tyre (Shqipëri, Argjentinë, Armeni, Bullgari, Kroaci, Gjeorgji, Lituani, Poloni, Portugali, Rumani, Rusi, Sllovaki “ish Republika Jugosllave e Maqedonisë”, Turqi), përveç kur gjyqtari kapet në flagrancë duke kryer një vepër penale (Hungari, Itali, Poloni, Rusi, Slloveni), ose kur bëhet fjalë për krim për të cilin jepet dënim me burg (Turqi, Slloveni). Në Zvicër, një magjistrat mund të dalë në përfundimin që një gjyqtar tjetër, përfshirë gjyqtarët e gjykatës federale, nuk është i aftë të kryejë funksionin e tij për shkak të mungesës së besimit nisur nga fakti që ai mund të jetë fajtor për një shkelje. Imunitet i plotë penal dhe civil gjendet gjithashtu në disa vende (Azerbajxhan, Estoni, Letoni, Lituani). Në Lituani, ky imunitet u jepet gjyqtarëve dhe në një gjendje luftë apo situatë të jashtëzakonshme. Në Rumani gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të jenë përgjegjës për opinionet dhe votat e shprehura gjatë kryerjes së funksioneve të tyre gjyqësore dhe gëzojnë imunitet, përfshirë dhe imunitet vepra penale që procedohen pa gjyq.⁶ Në përgjithësi, përfundimi është që gjyqtarët e gjykatës kushtetuese përfitojnë nga situata të veçanta në fushën e imunitetit, të ndryshme nga gjyqësori.

2.2 Përfundimet për standardet ndërkombëtare

Sipas standardeve europiane, është e padiskutueshme që gjyqtarët duhet të mbrohen kundër ndikimit të jashtëm. Për këtë qëllim, ata duhet të **gëzojnë imunitet nga ndjekja për**

⁴ “Magna Karta e Gjyqtarëve”, miratuar nga CCEJ në Strasburg më 19 nëntor 2010, neni 20.

⁵ Opinion nr. 3 i Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Europianë (CCJE) në vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës (2002).

⁶ Komisioni Europian për Demokraci përmes Ligjit, “Raport për përbërjen e gjykatave kushtetuese”, tetor 1997.

akte të kryera në ushtrim të funksioneve të tyre, me përjashtim të krimeve të paramenduara.⁷ Ata kanë nevojë për mbrojtje nga padi civile për veprime të bëra në mirëbesim gjatë funksioneve të tyre si dhe nga padi penale që synojnë të ndikojnë në lirinë dhe pavarësinë e vendimeve të tyre gjyqësore. Ky imunitet nuk shtrihet në çështje të krimeve të paramenduara si marrja e ryshfeteve, shmangie gjyqësore dhe shifra të tjera që lidhen me korrupsionin.

Në të njëjtën kohë, duhet theksuar **që gjyqtarët nuk duhet të përfitojnë nga imuniteti i përgjithshëm**. Përkundrazi, në një shtet të konsoliduar demokratik, gjyqtarët nuk duhen mbrojtur kundër ndjekjes për vepra penale të kryera nga ata dhe për të cilat duhet të përgjigjen në gjykatë.

⁷ "Raport për pavarësinë e sistemit gjyqësor", *Pjesa I: Pavarësia e gjyqtarëve*, miratuara nga Komisioni i Venecias në Seancën Plenare të 82të (Venecia, 12-13 mars 2010), Paragrafi 61.

3. RREGULLIMI I IMUNITETIT TË GJYQARËVE NË LIGJIN SHQIPTAR

3.1 Kuadri ligjor

3.1.1 Imuniteti përpara Kushtetutës së 1998

Shqipëria, pas ndryshimeve demokratike në 1990 dhe krijimit të një regjimi të ri kushtetues, prezantoi konceptin e imunitetit të gjyqtarëve në dispozita kushtetuese. Ligji kushtetues nr 7561 datë 29.04.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në ligjin nr 7491 datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”” për herë të parë në epokën demokratike të re parashikoi konceptin e imunitetit. Neni 10 i këtij ligji thotë që: *“Gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit kanë imunitet dhe nuk mund të lëvizin nga detyra gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre. Heqja e imunitetit si dhe lëvizja e tyre mund të bëhet vetëm nga organi kompetent, në rastet dhe sipas procedurës së caktuar me ligj. Asnjë ligj nuk mund të kufizojë garancitë e gjyqtarëve të parashikuara nga ky ligj kushtetues dhe nga rregullat ndërkombëtare.”*

Koncepti i imunitetit u shtjellua më shumë në ligjin nr 7574 datë 24.06.1992 “ Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet Procedurale Penale dhe Civile”. Neni 21 i këtij ligji përcakton që: *“Gjyqtarët, ndihmësgjyqtarët, prokurorët dhe hetuesit gëzojnë imunitet. Ata nuk mund të kontrollohen, të ndalohen, të arrestohen ose të ndiqen penalisht pa pëlqimin e organit që i ka zgjedhur ose emëruar. Ata mund të ndalohen pa këtë pëlqim vetëm në rastet kur kryejnë një krim të dukshëm e të rëndë.”*

Ligji kushtetues i sipërpërmendur nr 7561 datë 29.04.1992 gjithashtu krijoi për herë të parë një organ që do të realizonte garanci kushtetuese për shtetin e së drejtës dhe parimin e ndarjes së pushteteve. Neni 15 parashikoi krijimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si një organ që do të ofronte garanci për pavarësinë e sistemit të drejtësisë. Sipas nenit 15, *Këshilli i Lartë i Drejtësisë është i vetmi autoritet që vendos për emërimin, lëvizjen dhe përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve të shkallës së parë, të apelit si edhe të prokurorëve.* Ligji thotë gjithashtu që mënyra e funksionimit dhe e ushtrimit të veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Drejtësisë përcaktohet me rregulloren e miratuar nga Këshilli.

Parlamenti shqiptar në vitin 1997 miratoi një ligj të ri për sistemin e drejtësisë, ligjin nr 8265 datë 18.12.1997 “Për organizimin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj parashikon një rregullore të re për imunitetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, duke specifikuar çfarë do të përbënte krim, kryerja e të cilit do të çonte në arrestim, ndalim dhe ndjekje penale të një gjyqtari pa miratimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Neni 26 i këtij ligji thotë: *“Gjyqtarët dhe prokurorët gëzojnë imunitet. Ata nuk mund të kontrollohen, të ndalohen, të arrestohen ose të ndiqen penalisht pa pëlqimin e organit që i ka zgjedhur ose emëruar, me përjashtim të rasteve kur kryejnë një krim të dukshëm (flagrant) për të cilin*

parashikohet një dënim jo më pak se 5 vjet burg.” Ky rregullim ligjor ka qenë në fuqi vetëm për një vit. Nuk ka prova për të treguar nëse kjo dispozitë është përdorur nga Këshilli i Lartë.

3.1.2 Rregullimi i imunitetit që në 1998

Nëntori i vitit 1998 solli një Kushtetutë të re në Shqipëri. Kushtetuta e re parashikoi në mënyrë specifike imunitetin e gjyqtarëve. Neni 137, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës përcaktojnë: *“Gjyqtarët e tjerë mund të ndiqen penalisht vetëm me miratim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjyqtari mund të ndalohet ose të arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në qoftë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.”*

Miratimi i Kushtetutës së re solli dhe ndryshime në kuadrin ligjor për ta afruar atë me rregullimet e reja kushtetuese. U prezantua një ligj i ri për sistemin gjyqësor, ligji nr 8436 datë 28.12.1998 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”. Ligji, në nenin 26 përfshin dispozitën kushtetuese për imunitetin e gjyqtarëve dhe lexon: *“Gjyqtarët gëzojnë imunitet. Gjyqtarët e shkallës së parë dhe të apelit mund të ndiqen penalisht vetëm me miratim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Gjyqtari mund të ndalohet ose të arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në qoftë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.”*

Që nga ligjet e para kushtetuese në 1991, 1992 deri në 2001 kur u miratua ligji “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë Drejtësisë”, Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk ka vepruar bazuar në një ligj organik të vetin. Këshilli i Lartë i Drejtësisë u përmend dhe iu dha kompetenca për të emëruar, transferuar, pushuar gjyqtarët dhe për të hequr imunitetin në ligjin nr. 7561 datë 29.04.1992 (neni 15), në ligjin nr. 7574 datë 24.06.1992 (neni 21), në ligjin nr 8265 datë 18.12.1997 (neni 26), në ligjin nr 8436 datë 28.12.1998 (neni 26). Kishte dhe dy ligje të tjera që parashikonin për Këshillin e Lartë të Drejtësisë, por dispozitat e tyre fokusohen vetëm në përbërjen e Këshillit. Këto ligje janë ligji nr 8234 datë 27.8.1997 “Për një ndryshim në ligjin nr 7561 datë 29.04.1992 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr 7491 datë 29.04.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese””. Ligji i dytë ishte ligji nr 8235 datë 28.8.1997 “Për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”. Kështu, këto ligje nuk përmbanin ndonjë nen apo nuk parashikonin ndonjë procedurë ose raste apo veprimin e Këshillit në rast të heqjes së imunitetit të gjyqtarëve. Gjithë veprimtaria e Këshillit të Lartë të Drejtësisë bazohej në një rregullore të miratuar nga vetë Këshilli në vitin 1995. Për hir të kësaj analize, është bërë një kërkim në arkivat e Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe të Gjykatës së Lartë, por nuk është gjetur kjo rregullore. Gjenden procesverbalet e takimeve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë që nga krijimi i tij, por nuk

gjendet asnjë rregullore. Procesverbali vërteton miratimin e një rregulloreje. Gjithashtu, disa debate në shtypin e asaj kohe provojnë ekzistencën e rregullores. Në fillim të vitit 1998 u miratua dhe një rregullore tjetër, por përsëri është e pamundur të gjendet. Pak dihet për procedurat që janë ndjekur në raste të heqjes së imunitetit të gjyqtarëve. Megjithatë, të dyja këto rregullore nuk parashikonin ndonjë procedurë apo rregulla për heqjen e imunitetit. Nga procesverbali i takimit të Këshillit të Lartë të asaj kohe, mund të shihet që vendimet kryesisht janë bazuar në dëshirën dhe informacionin që ka pasur Këshilli, më shumë sesa në fakte ligjore.

Parlamenti shqiptar, në vitin 2001, miratoi një ligj organik për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ligjin nr 8811 datë 17.5.2001. Ligji hyri në fuqi, pothuajse një vit më vonë në prill 2002 për shkak të aplikimit të procedurës kushtetuese të vetos pezulluese presidenciale. Ligji nuk shprehej specifikisht për çështjen e imunitetit, por parashikonte takime të jashtëzakonshme të Këshillit. Neni 21, pika 1, në përputhje me dispozitën kushtetuese 137 pika 4 lexon: *“Në ato raste kur një gjyqtar ndalohet ose arrestohet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij, Këshilli i Lartë i Drejtësisë mblidhet brenda 24 orëve për të vendosur për lejimin ose jo të procedimit të mëtejshëm penal ndaj gjyqtarit.”*

Nisma për të reformuar Këshillin e Lartë të Drejtësisë u ndërmor në vitin 2005 nëpërmjet ndryshimeve të ligjit nr. 8811 datë 17.05.2001. Por shumë shpejt ligji shkoi në Gjykatën Kushtetuese. Një nga ndryshimet që u rishikua nga Gjykata ishte ai që i jepte imunitet anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë gjatë mandatit të tyre si anëtarë të Këshillit. Por ky ndryshim u gjet antikushtetues nga gjykata pasi *“imuniteti është institut që buron nga Kushtetuta si ligji bazë dhe dispozita ligjore që përcakton imunitetin që nuk jepet nga Kushtetuta konsiderohet antikushtetuese. Të gjithë anëtarët e Këshillit të Lartë gëzojnë imunitet për shkak të funksionit që përfaqësojnë në Këshill (Presidenti i Republikës, Kryetari, Ministri i Drejtësisë, gjyqtarët)”*.⁸

Ligji i ri dhe ekzistues nr 9877 datë 18.2.2008 *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri”* përcakton procedura më të detajuara në rast të heqjes së imunitetit të një gjyqtari. neni 29 parashikon përgjegjësinë penale të një gjyqtari dhe lexon:

“1. Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë ose gjyqtari i gjykatës së apelit mund të ndiqet penalisht, sipas dispozitave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale. Autorizimi për fillimin e procedimit penal bëhet me miratimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë. 2. Gjyqtari mund të ndalohet ose arrestohet vetëm në qoftë se kapet në kryerje e sipër të një krimi ose menjëherë pas kryerjes së tij. Organi kompetent njofton menjëherë Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Në qoftë se Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk jep pëlqimin brenda 24 orëve për dërgimin në gjykatë të gjyqtarit të arrestuar, organi kompetent është i detyruar ta lirojë atë.

⁸ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 14, datë 22.05.2006.

3. Në rastin kur ndaj një gjyqtari jepet autorizimi për fillimin e procedimit penal, ai pezullohet nga detyra derisa të merret vendim gjyqësor i formës së prerë.

1. Në rastet kur fajësia nuk provohet me vendim gjyqësor të formës së prerë të gjykatës, gjyqtari ka të drejtë të kthehet në punën e tij të mëparshme dhe të marrë pagën e plotë që nga koha e pezullimit.”

3.2 Praktika gjyqësore dhe jurisprudenca

Kuadri ligjor dhe kushtetues për çështjen e imunitetit të gjyqtarëve ka përjetuar shumë ndryshime. Gjatë viteve 90, imuniteti ka pasur një rregullim tjetër ligjor dhe kushtetues, të ndryshëm nga ai ekzistuesi. Kushtetuta e vitit 1998, në krahasim me ligjet e mëparshme kushtetuese, është me konkrete dhe fokusohet në mënyrë më të drejtpërdrejtë tek imuniteti. Neni 137, pikat 3 dhe 4 japin një koncept me të drejtpërdrejtë të imunitetit. Ato parashikojnë procedurën që duhet ndjekur në rastin e heqjes së imunitetit. Ato parashikojnë gjithashtu subjektet që janë përfshirë në procedura ose raste të heqjes së imunitetit. Në përfundim, ato parashikojnë procedura në raste të flagrancës. Ndryshe nga kjo, në ligjet e mëparshme kushtetuese, këto detaje dhe procedura i delegoheshin kuadrit ligjor, duke e bërë më të hapur ndaj ndryshimeve të mundshme. Nisur nga fakti që gjatë viteve 90 Këshilli i Lartë i Drejtësisë nuk kishte një ligj organik, por vepronte në bazë të një rregulloreje, ndryshimi që parashikoi kushtetuta e vitit 1998 në nenin 137, pikat 3 dhe 4 solli më shumë stabilitet, siguri dhe standardizim për imunitetin dhe procesin e heqjes së tij.

Këtu është e rëndësishme të theksohet dhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese për çështje të imunitetit. Çështja e gjykuar nga Gjykata nuk kishte të bënte në mënyrë specifike me imunitetin e gjyqtarëve, por ishte një interpretim i një çështjeje imuniteti për Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Neni 165 i Kushtetutës shprehet që Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit gëzon imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë. Por një ligj organik i vitit 2000 për Kontrollin e Lartë të Shtetit parashikoi që jo vetëm që Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit gëzonte imunitetin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, por edhe që heqja e tij nga detyra duhej të bëhej me të njëjtat procedura dhe kritere siç i parashikonte Kushtetuta për anëtarët e Gjykatës së Lartë. Në këtë çështje, Gjykata Kushtetuese u shpreh që:

*“Kushtetuta ka ndjekur kriterin se kur imuniteti nga ndjekja penale duhet shoqëruar edhe me garanci suplementare ose me klauzola specifike për funksionarin lidhur me qëndrimin e tij në detyrë, ajo e ka bërë këtë në mënyrë të shprehur. Jo vetëm kaq por, përderisa Kushtetuta ka trajtuar organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve dhe statusin e drejtuesve të tyre, ajo ka përcaktuar njëkohësisht edhe kufijtë e të drejtave të tyre. Për funksionet kushtetuese të organeve, **atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta nuk mund ta bëjë ligji**. Prandaj nuk mund të pranohet se ajo ka ometuar pa përmendur raste të tilla si “shkelja e Kushtetutës, kryerja e një krimi, akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën etj.”, atje ku nuk është shprehur. Si rrjedhojë, edhe në çështjen në shqyrtim ligji për Kontrollin e Lartë të Shtetit, duke kufizuar rastet e shkarkimit të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit*

*apo të mbarimit para kohe të mandatit pa u shprehur në Kushtetutë, ka kapërcyer caqet e kësaj të fundit*⁹.

Përvoja e marrëdhënieve ndërmjet Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme tregon që Këshilli i Lartë në të gjitha rastet ka qenë i gatshëm dhe i shpejtë që me kërkesë të Prokurorit të Përgjithshëm të diskutojë dhe të heqë imunitetin e gjyqtarëve. Që me miratimin e Kushtetutës 1998, Këshilli i Lartë ka marrë 11 kërkesa nga Prokurori i Përgjithshëm dhe 1 kërkesë nga Gjykata e Shkallës së Parë Gjirokastrë. Këshilli i Lartë i Drejtësisë ka miratuar 10 nga këto 12 kërkesa. Vetëm 2 kërkesat që nuk janë miratuar nga Këshilli lidhen me detaje procedurale. Kërkesa e parë nga Prokurori i Përgjithshëm u bë në mars 1999, por Këshilli nuk e shqyrtoi asnjëherë këtë kërkesë sepse gjyqtari u largua për arsye të tjera profesionale, për mosmarrje pjesë në provimin e kualifikimit. Kërkesa e dytë u paraqit në janar 2010, por Këshilli i Lartë vendosi që: *“Pasi u njoh me kërkesën e Kryetarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, paraqitur në Këshillin e Lartë të Drejtësisë nëpërmjet shkresës Nr. 54/1 prot., datë 28.01.2010, për dhënien e autorizimit për fillim procedimi penal ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, Rasim Doda, akuzuar për veprën penale të fyerjes, parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal, në përfundim vendosi të rrëzojë kërkesën për dhënie miratimi për fillimin e procedimit penal ndaj këtij gjyqtari, pasi u konstatua mosrespektim i afatit brenda të cilit, gjykata duhej të parashtronte kërkesën për të autorizuar procedimin.”*¹⁰

Në të njëjtën kohë, praktika në Shqipëri tregon që zakonisht imuniteti procedural paraqitet si pamundësi e prokurorit ose oficerit të policisë gjyqësore për të kryer veprime të cilat edhe pse të përkohshme, mund të prekin lirinë ose privacinë në fazën e hetimit paraprak. Prandaj, në fazën e hetimit paraprak, ndalimi i kryerjes së këtyre veprimeve lejon kryerjen e veprimeve hetimore dhe procedurale që nuk prekin lirinë personale; ndërkohë duket se kryerja e ndonjë veprimi hetimor nuk lejohet në asnjë rast.

Në praktikën e gjykatës dhe prokurorëve, është i zakonshëm një interpretim më i gjerë i nenit 289 të Kodit të Procedurës Penale. Prandaj deri në dhënien e autorizimit për procedim nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ndalohet kryerja e veprimeve jo vetëm e ndalimit ose përgjimit, por edhe veprimeve hetimore që nuk duhet të kenë vështirësi apo pengesë ligjore për t’u kryer nga Prokurori ose Policia Gjyqësore.

⁹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr, 212, datë 29.10.2002.

¹⁰ Vendim i Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. 258, datë 09.02.2010.

4. PROBLEMET E IMUNITETIT TË GJYQARËVE NË SHQIPËRI DHE SHKAQET E TYRE

Diskutimet për heqjen e imunitetit të gjyqtarëve kanë qenë çështje të debateve politike dhe publike të ditës, që në fillim të dekadës së shkuar. Edhe më përpara, gjyqësori shqiptar është përballur me raste të heqjes së imunitetit të një gjyqtari për shkaqe korrupsioni, por çështja e masave kushtetuese ose legjislative për heqjen e imunitetit të gjyqtarëve ka qenë tabu dhe shumë rrallë ka dalë në dritën e diskutimeve. Në fillim të dekadës së shkuar, sfidat e reja të Shqipërisë në zhvillimet politike dhe ligjore sollën në këtë vend një nivel të ri diskutimi të kësaj çështjeje. Ratifikimi nga Shqipëria i dokumenteve ndërkombëtare kundër korrupsionit, e çoi luftën kundër korrupsionit dhe diskutimet për imunitetin e nëpunësve publikë, përfshirë gjyqtarëve, në një nivel të rëndësishëm të debatit publik dhe programit politik. Këto debate, në veçanti janë intensifikuar pas vitit 2004 dhe 2005.

Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar disa dokumente ndërkombëtare që i dedikohen luftës së kundër korrupsionit, me masa si politika parandaluese model, rritja e transparencës, kriminalizimi i korrupsionit, etj. Sipas këtyre standardeve ndërkombëtare, shtetet duhet të përpiqen të sigurojnë që shërbimet publike t'i nënshtrohen masave që nxisin efikasitet dhe transparencë. Transparenca dhe përgjegjshmëria duhet të nxiten dhe kërkesat specifike duhen përcaktuar për parandalimin e korrupsionit, sidomos në fusha kritike të sektorit publik, siç është gjyqësori. Një dokument i këtij lloji i rëndësishëm është Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit.¹¹ Konventa i kërkon direkt shteteve anëtare të marrin masa në lidhje me gjyqësorin dhe prokurorinë.¹² Në nene të tjera të kësaj Konvente, Shteteve Anëtare u kërkohet të gjejnë një ekuilibër ndërmjet imunitetit dhe mundësisë për hetim dhe ndjekje të efektshme.¹³

Shqipëria ka nënshkruar dhe ka ratifikuar gjithashtu konventën tjetër të rëndësishme kundër krimit dhe korrupsionit.¹⁴ Kjo konventë u kërkon shteteve palë të miratojnë masa

¹¹ *Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit* miratuar në 2003 dhe në fuqi në 2005. Republika e Shqipërisë e nënshkroi në 18 dhjetor 2003 dhe e ratifikoi në 25 maj 2006

¹² Neni 11, pika 1, lexon si vijon: *Masat në lidhje me gjyqësorin dhe prokurorinë*

Duke pasur parasysh pavarësinë e gjyqësorit dhe rolin e tij thelbësor në luftën kundër korrupsionit, cdo Shtet pale, në përputhje me parimet themelore të sistemit të tij ligjor dhe oa cenuar pavarësinë gjyqësore, merr masa për të forcuar integritetin dhe për të parandaluar mundësitë për korrupsion mes anëtarëve të gjyqësorit. Këto masa mund të përfshijnë rregulla në lidhje me sjelljen e anëtarëve të gjyqësorit.

¹³ Neni 30, pika 2, lexon si më poshtë: *Çdo Shtet Palë merr masat që janë të nevojshme për të krijuar ose ruajtur, në përputhje me sistemin e tij ligjor dhe parimet kushtetuese, një ekuilibër të duhur ndërmjet imuniteteve ose privilegjeve juridikionale që i janë dhënë nëpunësve publik për kryerjen e funksioneve të tyre dhe mundësisë, kur është e nevojshme, të hetimit të efektshëm, investigimit, ndjekjes dhe gjykimit të shkeljeve të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë.*

¹⁴ *United Nations against Transnational Organized Crime* adopted in 2000 and entered into poëer in 2003. The Republic of Albania has signed it 12 December 2000 and ratified it in 21 Aug 2002.

legjislative dhe të tjera për të përcaktuar korrupsionin si vepër penale¹⁵ dhe përfshirjen e duhur dhe konsistente me sistemin e tyre ligjor, për të miratuar masa legjislative, administrative ose të tjera të efektshme për të nxitur integritet dhe për të parandaluar, zbuluar dhe ndëshkuar nëpunësit publik.¹⁶

Një tjetër dokument i rëndësishëm në kuadrin ndërkombëtar të luftës kundër korrupsionit është Rezoluta e Këshillit të Europës (97) 24 për Njëzet Parimet Udhëzuese për Luftën kundër Korrupsionit.¹⁷ Komiteti i Ministrave i Këshillit të Europës bie dakord për njëzet parime udhëzuese për të luftuar korrupsionin. Rezoluta synon gjithashtu të nxisë një proces dinamik për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin në mënyrë të efektshme. Parimet udhëzuese përfshijnë rritjen e ndërgjegjësimit, përmirësimin e procedurave të hetimit dhe të ndjekjes, nxitjen e specializimit të personave ose organeve përgjegjëse për të luftuar korrupsionin si edhe rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar. Për hir të analizës, parimi 6 i këtyre udhëzimeve duhet të përmendet. Parimi 6 lexon si vijon: ***të kufizohet imuniteti nga hetimi, ndjekja apo gjykimi i veprave korruptive në masën e nevojshme në një shoqëri demokratike.***

4.1 Probleme në lidhje me luftën kundër korrupsionit

Pavarësisht ndikimit ndërkombëtar në çështjen e imunitetit të gjyqtarëve, zhvillimet e brendshme në luftën kundër korrupsionit, si fenomen që është ngritur shpesh në raportet ndërkombëtare për Shqipërinë, nxori në dukje problemet e akumuluar gjatë viteve, por që tani shfaqen tepër shqetësuese. Prokuroria shpesh ka deklaruar vështirësinë me të cilën përballlet në çështje korrupsioni ku përfshihen gjyqtarët. Imuniteti i gjyqtarëve mund të parandalojë hetimin e një çështjeje korrupsioni të një gjyqtari. Sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale, në momentin që prokuroria vihet në dijeni për një rast të mundshëm korrupsioni ku përfshihet një gjyqtar, prokuroria nuk mund të veprojë në asnjë rrethanë për të thelluar hetimin kundër gjyqtarit, nëse autorizimi nuk është dhënë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Për të dhënë këtë autorizim, Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe gjyqtari gjithashtu, njoftohen për çështjen, akuzat dhe elementët hetimore të dosjes. Sigurisht kjo mund ta pengojë për veprime të mëtejshme të paligjshme. Prokuroria mund dhe duhet të gjejë mënyra të mundshme për të hetuar çështjen me detaje; megjithatë, pa dyshim, imuniteti i gjyqtarit mund të jetë pengesë e konsiderueshme në hetimin e plotë dhe të qartë të korrupsionit mes gjyqtarëve. Natyrshëm, korrupsioni, duket se gjendet jo vetëm mes gjyqtarëve, por edhe mes prokurorëve, dhe duhet të ketë mënyra dhe masa për të luftuar korrupsionin edhe mes prokurorëve, por kjo çështje është jashtë fushës së kësaj analize.

¹⁵ *Ibid*, article 8.

¹⁶ *Ibid*, neni 9, pika 1.

¹⁷ Rezolutë e miratuar nga Komiteti i Ministrave në 6 nëntor 1997 në sesionin e 101të të Komitetit të Ministrave.

4.2 Probleme në lidhje me barazinë përpara ligjit

Imuniteti i gjyqtarëve është një çështje shumë e rëndësishme, por shumë delikate gjithashtu. Bazuar edhe në vendimin e Gjykatës së Lartë nr 6 të datës 14.9.2009 që përcakton se *“imuniteti i deputetit nuk është një garanci personale e tij, por një mjet kushtetues për të siguruar funksionimin normal të Kuvendit si institucion”*. Po kështu gjyqtarët duhet të gëzojnë imunitetin e tyre jo si mburojë personale ndaj korrupsionit, por si mbrojtje institucionale e pavarësisë së tyre siç thuhet në pjesën e parë të raportit aktual. Kjo mbrojtje duhet të interpretohet si një garanci që jep shteti i së drejtës, jo për gjyqtarin, por për ruajtjen e shtyllave të shtetit të së drejtës, pavarësisë së drejtësisë dhe ndarjes së kompetencave.

Megjithatë, për qëllim të barazisë përpara ligjit, garancitë shtesë që i jepen një gjyqtari krahasuar me një individ të thjeshtë, krijojnë, *prima facie*, një ndjesi negative tek publiku në lidhje me çekuilibrin ndërmjet punonjësit shtetëror me imunitet dhe individit. Kjo shpesh është keqpërdorur në debate politike mes forcave politike dhe është pasqyruar në perceptimin që ka publiku ndaj sistemit gjyqësor. Korrupsioni i prezumuar i shumë zyrtarëve mund të jetë amortizuar me kalimin e diskutimit tek imuniteti i gjyqtarëve.

Në përfundim, niveli i korrupsionit në gjyqësor dhe perceptimi i publikut në lidhje me atë, debatet politike dhe publike në lidhje me korrupsionin në gjyqësor, ndjeshmëria për mosndëshkimin e gjyqtarëve dhe imunitetin e gjyqtarëve janë çështje që duhen ekuilibruar sipas standardeve demokratike ndërkombëtare që ka ratifikuar Shqipëria ose ku synon të bëhet pjesë.

4.3 Probleme procedurale

Problemet procedurale lidhen në radhë të parë me dispozitat kushtetuese për hapat që duhen ndjekur për të filluar procedim penal kundër një gjyqtari. Kuadri kushtetues dhe ligjor për çështjen e imunitetit të gjyqtarëve ka kaluar nëpër shumë ndryshime. Gjatë viteve 90, imuniteti kishte një rregullore tjetër kushtetuese dhe ligjore, të ndryshme nga kjo ekzistuese. Kushtetuta e vitit 1998, në krahasim me ligjet e mëparshme kushtetuese, është me konkrete dhe ka prirje ose orientim më të drejtpërdrejtë në lidhje me imunitetin. Neni 137, pikat 3 dhe 4 japin një koncept me të drejtpërdrejtë të imunitetit. Ato parashikojnë procedurën që duhet ndjekur në rastin e heqjes së imunitetit. Ato parashikojnë gjithashtu subjektet që janë përfshirë në procedura ose raste të heqjes së imunitetit. Ato parashikojnë procedura në raste të flagrancës. Ndryshe nga kjo, në ligjet e mëparshme kushtetuese, këto detaje dhe procedura i delegoheshin kuadrit ligjor, duke e bërë më të hapur ndaj ndryshimeve të mundshme. Ndryshimi që parashikoi kushtetuta e vitit 1998 në nenin 137, pikat 3 dhe 4 solli më shumë stabilitet, siguri dhe standardizim për imunitetin dhe procesin e heqjes së tij. Por në të njëjtën kohë, këto dispozita krijojnë kushte më të rrepta për ndjekjen

e një gjyqtari. Neni 137 pika 3 e Kushtetutës qartë thotë që *“Gjyqtarët e tjerë mund të ndiqen penalisht vetëm me miratim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë”*. Kështu, sipas interpretimit më të zakonshëm të këtij neni, prokuroria nuk ka mjete të tjera hetimi, por duhet të njoftojë Këshillin e Lartë të Drejtësisë dhe të kërkojë autorizimin e tij. Sipas praktikave të kërkesave të prokurorisë tek Këshilli i Lartë, prokuroria nuk mund të ndër marrë veprime hetimore si përgjim, përgjim mjedisor etj apo masa të tjera hetimore nëse nuk jepet autorizim nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Pavarësisht përvojës së mirë të bashkëpunimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë në raste të këtyre kërkesave nga prokuroria, fshehtësia dhe konfidencialiteti i çështjes dhe elementëve hetimore është shkelur.

5. PËRMIRËSIME TË SUGJERUARA PËR SITUATËN SHQIPTARE

Sipas konsideratave të mëparshme, të pasqyruara dhe në raportet ndërkombëtare për drejtësinë në Shqipëri, imuniteti i gjyqtarëve siç rregullohet dhe zbatohet sot mund të jetë pengesë për luftën kundër korrupsionit dhe mund të kuptohet në perceptimin publik si një privilegj tepër i lartë që cenon barazinë e qytetarëve përpara ligjit.¹⁸

Kështu, imuniteti i përgjithshëm duhet hequr, për të siguruar barazi përpara ligjit dhe për të lehtësuar luftën kundër korrupsionit në gjyqësor. Sipas standardeve të përmendura, nuk ka dyshim që gjyqtarët shqiptarë duhet të përgjigjen përpara ligjit për shkelje të kryera jashtë funksionit të tyre gjyqësor.

Për respektimin e standardeve ndërkombëtare ne rekomandojmë reformimin e kuadrit ligjor shqiptar me qëllim që të garantohet në mënyrë ekskluzive imuniteti i gjyqtarëve që duhet të mbrohen vetëm ndaj padive civile dhe kërkesave penale bazuar në vendimet e marra në ushtrim të funksioneve të tyre. Pra imuniteti lidhet me “opinionet e shprehura ose votën e dhënë”. Vetëm nëse në vendimin gjyqësor tregohet synimi ose keqdashja, gjyqtari mund të ndiqet penalisht dhe do të mbajë gjithashtu përgjegjësi civile për rezultatet e veprimeve të tij. I tillë është rasti i shmangies.

Duke pasur parasysh situatën aktuale, është veçanërisht e nevojshme që prokurorëve t’u jepet mundësia për të filluar hetimin për krime të mundshme të kryera nga gjyqtarët pa nevojën e autorizimit paraprak të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Sipas standardeve ndërkombëtare, duhet të ketë vetëm pak përjashtime për rregullimin e përgjegjësisë së përgjithshme të gjyqtarëve për vepra të kryera privatisht: vetëm për çështjet ku është e dukshme, keqpërdorimi i veprimeve gjyqësore si mënyrë për të ndikuar në vendimet gjyqësore që duhet të merren për një çështje konkrete ose kur preket në thelb funksionimi i gjykatës në fjalë; gjithashtu gjyqtarët e gjykatave më të larta që merren me çështje tepër delikate nga këndvështrimi politik mund të përfitojnë disa privilegje për të siguruar pavarësinë e tyre për sa kohë që mund të jenë nën presion më të madh dhe të vazhdueshëm.

Në të njëjtën kohë, standardet ndërkombëtare nuk janë kaq të rrepta në lidhje me **pacenueshmërinë personale** të gjyqtarëve. Prandaj, disa kufizime për mundësinë e arrestimit ose ndalimit të gjyqtarëve mund të jenë në përputhje me standardet europiane. Kjo është veçanërisht e qartë në rastin e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, e cila është organ juridiksional që lidhet me epërsinë ose kushtetutës mbi pushtetet e shtetit. Për shkak të pozicionit të veçantë të kësaj gjykate, si fuqia më e madhe brenda shtetit kushtetues, këshillohet shmangia e ndërhyrjeve që lehtësisht mund të kenë pasojë në përbërjen e saj dhe, kështu, në rezultatit e vendimeve të saj.

¹⁸ Për shembull, ndërhyrja e Z. Ilir Rusmali në seancën për imunitetin që u mbajt në Kuvend në 23 tetor 2008 ku ai nuk gjeti një zgjidhje të arsyeshme dhe të drejtë për funksionimin e gjyqësorit që gjyqtarët kishin një qëndrim të përbashkët në lidhje me korrupsionin dhe çështje të tjera të paligjshme. Ai tha gjithashtu që ata kishin zgjedhur të mbronin kolegët e tyre dhe jo të luftonin korrupsionin.

Në nivel ndërkombëtar, për të shmangur praktikat që synojnë përcaktimin e përmbytjes së vendimeve gjyqësore duke ndryshuar përbërjen e organeve gjyqësore, ndalimi i gjyqtarëve shpesh i nënshtrohet kushteve të veçanta. Në disa vende nevojitet autorizim paraprak i Këshillit të Lartë të Drejtësisë¹⁹, dhe në të tjera vetëm kërkesa që Këshilli të vihet në dijeni për këtë fakt²⁰. Duke pasur parasysh situatën aktuale në Shqipëri, ne rekomandojmë të mbahet garancia në lidhje me nevojën e miratimit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për ndalimin e gjyqtarëve. Në këto raste, as hetimi paraprak, as veprimet gjyqësore nuk duhet të ndalojnë në pritje të ndërhyrjes nga Këshilli, që lidhet vetëm me ndalimin fizik të gjyqtarit.

5.1 Reformimi i procedurave për heqjen e imunitetit

Që në kohën e hartimit të Kushtetutës së përkohshme shqiptare në 1995, institucionet europiane kanë vënë në dukje nevojën për një procedurë të heqjes së imunitetit të gjyqtarëve, bazuar në arsye të përbashkëta dhe të përcaktuara rreptësisht.²¹ Sa kohë që imuniteti ekzistonte në sistemin shqiptar, do të duhej të qartësohej procedura e heqjes së imunitetit. Për të shmangur dyshimin për arbitraritet dhe për të rritur transparencën në luftën kundër korrupsionit, procedurat e heqjes së imunitetit do të bëhen publike, miratohen dhe detajohen paraprakisht.

Në këtë mënyrë, nëse kompetenca në lidhje me imunitetin i takon Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ne rekomandojmë miratimin e akteve nënligjore me rregulla për heqjen e imunitetit, për të rregulluar procedurën me detaje: specifikimin e të gjitha afateve për depozitimin e kërkesës, organin kompetent brenda Këshillit, dokumentacionin e paraqitur dhe përmbytjen e mundshme të vendimit.

Nëse rregullat shqiptare ndryshohen për të hequr imunitetin e përgjithshëm, në Këshillin e Lartë të Drejtësisë nuk duhet të ketë procedurë për heqjen e imunitetit; rastet e imunitetit funksional duhet të konsiderohen *ex officio* nga prokurorët dhe gjyqtarët. Kjo do të varet nga provat e mbledhura në çdo rast nga prokurorët, të vlerësuara nga gjyqtarët e shkallës së parë, për të vendosur nëse në ndonjë vendim gjyqësor gjyqtari ka patur synim të parregullt, e kështu për të vendosur që gjyqtari të ndiqet për atë veprim.

Nuk këshillohet krijimi i një sistemi ku Këshilli i Lartë i Drejtësisë të jetë përgjegjës për të analizuar me kërkesë të një gjyqtari të akuzuar, nëse një kërkesë penale bazuar në një vendim gjyqësor është mbështetur vërtet në synimin e gjyqtarit. Nga njëra anë, ky mekanizëm mund të keqpërdoret dhe të bëhet në praktikë një imunitet i përgjithshëm, pasi përgjegjësia e gjyqtarit

¹⁹ Shihni nenin 122 të Kushtetutës së Malit të Zi

²⁰ Neni 107 i Kushtetutës së Kosovës

²¹ Shihni Opinionin e Komisionit të Venecias “Për ligjin shqiptar për organizimin e gjyqësorit”, B1. Në 26 qershor 1995, përpara anëtarësimin të Shqipërisë në Këshillin e Europës, Komisioni Parlamentar i Çështjeve Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut i kërkoi Komisionit të Venecias të shqyrtojë dispozitat kushtetuese që rregullojnë pavarësinë e gjykatave në Shqipëri dhe të jepte një mendim në lidhje me to. Komisionit miratoi këtë raport në seancën e tij të 25të..

do të varej gjithmonë nga një vendim i Këshillit për të lidhur kërkesën me ushtrimin e funksionit gjyqësor. Nga ana tjetër, këto vendime të bordit gjyqësorit mund të kuptohen si ndërhyrje në pavarësinë e gjyqtarëve të vetëm që janë të vetmit kompetentë për të gjykuar themelin e një çështjeje konkrete.

5.2 Reformimi i ligjeve për procedurën

Reforma e sistemit të imunitetit të gjyqtarëve, pasqyrohet në ligjet përkatëse në lidhje me pozicionin e gjyqtarëve.

Ne rekomandojmë që neni 21, pika 1 e ligjit organik për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (Ligji nr 8811, datë 17.5.2001) të ndryshohet që Këshilli i Lartë i Drejtësisë të mos duhet të vendosë për vazhdimin apo jo të procedimeve të mëtejshme penale kundër një gjyqtari. Në vend të kësaj, do të kërkohej rregullimi i parimeve bazë të procedurës për autorizimin e ndalimit të një gjyqtari nëse do të prekej funksionimi i gjykatës së tij. Në të njëjtën kohë, neni 29 i ligjit organik për organizimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri (ligji nr 9877 datë 18.2.2008) nuk duhet të përmbajë referencë për nevojën e autorizimit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për procedim kundër një gjyqtari.

Nëse qeveria shqiptare trajton më në fund reformën e premtuar të kodeve të procedurës civile dhe penale, ne rekomandojmë që të ndryshojë gjithashtu nenet në lidhje me autorizimin për të proceduar. Duket veçanërisht i nevojshëm ndryshimi i nenit 289 të Kodit të Procedurës Penale. Ky nen i shtrin garancitë e paprekshmërisë personale jo vetëm tek arrestimet, ndalimet dhe masat që kufizojnë lirinë e lëvizjes, por dhe në masat e tjera të hetimit siç janë identifikimi apo përgjimi i komunikimeve. Në praktikë, kjo ka çuar në moskryerjen e hetimeve nga policia dhe prokuroria për personat e privilegjuar, në rast se arrestimi i tyre është i ndaluar.

5.3 Reformimi i Kushtetutës

Në Kushtetutën shqiptare ka disa nene në lidhje me imunitetin e gjyqtarëve. Ndryshimi i disa prej tyre mund të këshillohet për të qartësuar parimet kushtetuese në lidhje me garantimin e pavarësisë së gjyqësorit, për atë që pasqyrohet në këtë raport. Megjithatë, Kushtetuta duhet të jetë një rregull i përgjithshëm, që mund t'i ofrojë vendit stabilitet dhe të pasqyrojë një sistem të hapur politik dhe ligjor i cili mundëson zgjidhje të ndryshme politike të përshtatura me kërkesat e çdo momenti historik ose ideologjive të ndryshme. Prandaj, nuk këshillohet që kushtetuta të jetë po aq e detajuar sa kodi i procedurës civile ose penale për të dhënë një zgjidhje për problemin konkret. Në këtë rast, synimi për t'i dhënë një status të veçantë pandryshueshmërisë së disa mandateve shumë specifike, mund të sjellë një pasojë të padëshiruar, siç është mungesa e stabilitetit të vetë Kushtetutës.

Prandaj, ne konsiderojmë që në lidhje me rregullat për imunitetin në gjyqësor, Kushtetuta duhet të ndryshohet vetëm për të shmangur përdorimin e dispozitave të saj si

pengesë për luftën kundër korrupsionit. Nëse Kushtetuta vendos një sistem të gjerë të imunitetit që nuk mund të ngushtohet dhe profilizohet me ligj, këshillohet që të ndryshohet. Në anën tjetër, kur Kushtetuta është mjaftueshëm e hapur për të lejuar zgjidhje të ndryshme, duke përfshirë imunitetin më të kufizuar, nuk ka pse të ndryshohet.

Nga ky këndvështrim, mundësitë që ofron reformimi i mundshëm i Kushtetutës duhet të konsiderohen me anë të analizës së veçantë të çdo neni përkatës:

5.3.1 Në lidhje me imunitetin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese

Duhet theksuar që Gjykata Kushtetuese nuk është tamam pjesë e gjyqësorit, por një organ kushtetues i shtetit që ka kompetencë të garantojë efikasitetin e Kushtetutës, kryesisht për ligje dhe rregulla që miraton Parlamenti. Prandaj, ligjet shqiptare nuk janë të detyrueshme për gjykatës Kushtetuese ose janë të tilla vetëm pasi ajo të ketë verifikuar kushtetutshmërinë e tyre. Gjykata është një dhomë juridiksionale, sa kohë që vendimet e saj duhet të arsyetohen dhe paraqiten si një interpretim i pavarur i Kushtetutës, por formalisht është fuqi e jashtëzakonshme që kontrollon legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin. Për këtë arsye, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese në shumë vende përfitojnë garanci procedurale kundër ndërhyrjeve të ndonjërit nga këto pushtete.²²

Megjithatë, standardet aktuale shqiptare janë dukshëm për shtrirjen e imunitetit që u jepet këtyre gjyqtarëve kushtetues.²³ Neni 126 duke përcaktuar që ata nuk mund të ndiqen penalisht pa miratimin e gjykatës, krijon mundësinë për mosndëshkim pasi nuk vendos ndonjë kufi për mundësinë e gjykatës për të refuzuar ndjekjen penale. Në lidhje me pacenueshmërinë personale, neni mundëson interpretimin që këta gjyqtarë mund të ndalohen vetëm në rast të kapjes në flagrancë gjatë kryerjes së një krimi, por jo në ndonjë rrethanë tjetër, psh kur këtë e vendos një gjyqtar.

Për mendimin tonë, këto garanci mund të reduktohen duke pasur gjithmonë parasysh pozicionin e veçantë të juridiksionit kushtetues. Në këtë kuptim, do të këshillohej që të krijohet një lidhje e imunitetit të gjyqtarëve të gjykatës kushtetuese me atë të deputetëve, siç ndodh në shumë vende.

Në çdo rast, rekomandojmë ndryshimin e nenit 126. Rregulli i ri duhet të garantojë imunitetin e tyre funksional për faktin që *gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ndiqen civilisht ose penalisht për opinione të shprehura në ushtrim të funksioneve të tyre. Ligji organik i Gjykatës Kushtetuese rregullon procedurat për të garantuar përgjegjësinë e*

²² Kështu për shembull, kushtetuta kroate dhe sllovene –mes të tjerash- përcakton që gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese përfitojnë të njëjtin imunitet si deputetët. Në Maqedoni e njëjta garanci përfshihet në ligj. Për informacion të detajuar për këtë çështje, shihni raportin e Komisionit të Venecias: “Përbërja e gjykatave kushtetuese”, nga Komisioni European për Demokraci nëpërmjet Ligjit, Këshilli i Europës, 1998, faqe 24.

²³ Megjithatë duhet theksuar që Shqipëria nuk bën dallim as në këtë pikë. Në Lituani për shembull, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk mund të jenë penalisht ose administrativisht, nuk mund të arrestohen dhe nuk mund t’i nënshtrohen kufizimi tjetër të lirisë personale pa miratimin e Gjykatës Kushtetuese.

tyre për shkelje të kryera jashtë funksionit të tyre në kushte të njëjta si përgjegjësia e deputetëve.

Projekti i ri i këtij neni duhet të parashikojë gjithashtu që një gjyqtar i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të arrestohet apo t'i hiqet lira në çfarëdo forme pa autorizimin e vetë gjykatës, përveçse nëse kapet gjatë kryerjes ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Në këtë rast, Prokurori i Përgjithshëm vë menjëherë në dijeni Gjykatës Kushtetuese që mund të vendosë për heqjen e masës.

5.3.2 Në lidhje me imunitetin e gjyqtarëve

Në lidhje me gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, neni ekzistues 137 i Kushtetutës mundëson që ata të ndiqen vetëm me miratimin e parlamentit. Arsyeja e kësaj lidhjeje me parlamentin është sistemi shqiptar i emërimeve. Megjithatë, sipas disa raporteve ndërkombëtare, gjykata e lartë duhet të organizohet në mënyrë progresive si gjykatë karriere e përfshirë plotësisht në gjyqësor. Prandaj, ne rekomandojmë që të shtrihen për gjyqtarët e saj të njëjtat garanci që i jepen pjesës tjetër të gjyqësorit.

Ne gjithashtu rekomandojmë që Këshilli i Lartë të Drejtësisë të ketë mundësinë e pushimit të arrestit të një gjyqtari nëse preket në thelb funksionimi i gjykatës në fjalë. Megjithatë, në të njëjtën kohë, duhet të jetë e qartë që pushimi i ndalimit personal nuk pengon vazhdimësinë e hetimeve paraprake dhe ndjekjes penale.

Në përfundim, ne konsiderojmë të këshillueshme reformimin e nenit 137 të Kushtetutës. Varianti i ri duhet të përcaktojë që *gjyqtarët nuk mund të ndiqen penalisht ose civilisht për shprehje të përdorura dhe vendime të marra në ushtrim të funksioneve të tyre gjyqësore, përveçse për krime të paramenduara të parashikuara në mënyrë specifike të Kodin Penal.*

Gjithashtu, ne rekomandojmë që të qartësohet në këtë nen që *një gjyqtar nuk mund të arrestohet apo t'i hiqet lira në çfarëdo forme pa autorizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përveçse nëse kapet gjatë kryerjes ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Në këtë rast, Prokurori i Përgjithshëm vë menjëherë në dijeni Këshillin e Lartë të Drejtësisë që mund të vendosë për heqjen e masës.*

6. PËRFUNDIME

6.1 Rekomandime për reformimin e imunitetit të gjyqtarëve

- a) *Imuniteti i përgjithshëm duhet hequr. Gjyqtarët duhet të përgjigjen përpara ligjit për shkelje të kryera jashtë funksionit të tyre gjyqësor.*
- b) *Gjyqtarët duhet të mbrohen vetëm ndaj padive civile dhe kërkesave penale bazuar në opinionet e shprehura ose votat e dhëna gjatë ushtrimit të funksioneve.*
- c) *Prokurori kompetent duhet të jetë në gjendje të bëjë hetimin për krime të mundshme të kryera nga gjyqtarët pa nevojën e autorizimit paraprak nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë.*
- d) *Nëse tregohet qëllimi ose keqdashja në një vendim gjyqësor, gjyqtari mund të ndiqet penalisht dhe të jetë gjithashtu civilisht përgjegjës për rezultatit e këtyre veprimeve.*
- e) *Gjyqtarët nuk duhet të arrestohen apo t'ju kufizohet liria e lëvizjes në çfarëdo forme pa autorizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përveç rastit kur kapen në flagrancë gjatë kryerjes së krimi të rëndë.*
- f) *Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese nuk duhet të përfitojnë nga imuniteti i përgjithshëm, por nga një regjim procedural i ngjashëm me atë që ju jepet deputetëve.*
- g) *Neni 126 dhe 137 i Kushtetutës duhet të ndryshohet.*
- h) *Ligji organik për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ligji organik për organizimin e pushtetit gjyqësor në Shqipëri, Kodi i Procedurës Civile dhe Kodi i Procedurës Penale, duhet të ndryshohen.*

6.2 Propozim konkret në lidhje me ndryshimin e Kushtetutës:

Ndryshimi i Kushtetutës duhet të jetë rezultat i një konsensusi të thellë brenda forcave politike shqiptare. Megjithatë, një shembull i një teksti të ri që mund të jetë sipas standardeve ndërkombëtare do të ishte si vijon:

Neni 126

Gjyqtarët i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të ndiqen civilisht ose penalisht për opinione dhe vendime të nxjerrja në ushtrim të funksioneve të tyre. Ligji organik i Gjykatës Kushtetuese rregullon procedurat për të garantuar përgjegjësinë e tyre për shkelje të kryera jashtë funksionit të tyre në kushte të njëjta si përgjegjësia e deputetëve.

Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese nuk mund të arrestohet apo t'i hiqet liria në çfarëdo forme pa autorizimin e vetë gjykatës, përveçse nëse kapet gjatë kryerjes ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Në këtë rast, Prokurori i Përgjithshëm vë menjëherë në dijeni Gjykatës Kushtetuese që mund të vendosë për heqjen e masës.

Neni 137

Gjyqtarët nuk mund të ndiqen penalisht ose civilisht për shprehje të përdorura dhe vendime të marra në ushtrim të funksioneve të tyre gjyqësore, përveçse për krime të paramenduara të parashikuara në mënyrë specifike të Kodin Penal.

Gjyqtari nuk mund të arrestohet apo t'i hiqet lira në çfarëdo forme pa autorizimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, përveçse nëse kapet gjatë kryerjes ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Në këtë rast, Prokurori i Përgjithshëm vë menjëherë në dijeni Këshillin e Lartë të Drejtësisë që mund të vendosë për heqjen e masës.

Në Tiranë, 1 tetor 2011

Joaquin Urias
Drejtues Misioni